



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:193053

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438324

Ac.nr.3337/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Nora Bllaca Dula - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.G. nga fshati S., Komuna e L., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S. K. avokat në P., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë - Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti vërtetim diskriminimi dhe kompensim i pagave jubilarë, me vlerë të kontestit 436.92 euro, duke vendosur sipas ankesës paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7093/2021 të datës 31.01.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit, F. G. nga fshati S, Komuna e L, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7093/2021, i datës 31.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.7093/2021 të datës 31.01.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit F. G. nga fshati S., Komuna e L. me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet diskriminimi ndaj paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, të ia paguaj një pagë mujore neto në shumë prej 436.92 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, e PABAZUAR. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar secilën palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e e aprovuar në tërësi si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit e po ashtu ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, F. G. nga fshati S., Komuna e L., përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, S.K., avokat nga Prishtina, me datë 12.08.2021 ka ushtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Drejtësisë - Prishtinë, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguaj një pagë mujore neto në shumë prej 436.92 euro me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimin nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë duke vlerësuar se nuk ka bazë ligjore pasi që pretendimet e paditësit janë mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila Marrëveshje – Kontratë ishte në fuqi nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2017, që si rrjedhojë kërkesëpadia nuk ka bazë ligjore, pasi që Oda Ekonomike si partnerë i barabartë në Këshillin Ekonomik –Social dhe nënshkruese e Marrëveshjes Kolektive të Kosovës, është tërhequr nga zbatimit i marrëveshjes 3 muaj para zbatimit të vlefshmërisë së saj. Tutje, ka shtuar se ashtu siç është përcaktuar me Ligjin e Punës nga neni 90 par.4 ku Marrëveshja Kolektive kishte filluar së zbatuari me dt. 01.01.2015 në vlefshëri prej 3 vite. Më tej ka theksuar se dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës përcakton afatin e parashkrimit:” Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen në afatin prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, jashtë seance, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.7093/2021 të datës 31.01.2022 me të cilin refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën dhe atë data 01.12.2008, fakt ky që konstatohet edhe nga Vërtetimi i datës 23.12.2020 lëshuar nga e paditura sipas kërkesës së paditësit. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (tutje si MPKK), në të cilën mbështetet kërkesëpadia e paditësit, ka hyrë në fuqi me

datë 01.01.2015. Me dispozitën e nenit 90 paragrafi 4 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, përcaktohet se “*Marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*” andaj zbatimi i kësaj marrëveshje ka përfunduar pas kalimit të afatit tre (3) vjeçar të hyrjes së saj në fuqi, e që është data 31.12.2017. Meqenëse paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 01.12.2008 dhe atë në kohë të pacaktuar, Gjykata vlerëson se i njëjti ka arritur dhjetë (10) vite përvojë pune tek e paditura me datë 01.12.2018, pra pas skadimit të vlefshmërisë së MPKK-së. Në këtë kuptim, kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar në emër të dhjetë (10) viteve përvojë pune nuk gjen mbështetje në MPKK-në e lartë cituar pasi që Marrëveshja në fjalë nuk prodhon efekt juridik përtej kohës së vlefshmërisë së saj dhe se në kohën kur paditësi ka përmbushur dhjetë (10) vite përvojë pune, nuk ka qenë në fuqi asnjë Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive tjetër e cila e ka njohur të drejtën për shpërblim jubilar. Sa i përket kërkesëpadisë që ka të bëjë me vërtetimin e diskriminimit ndaj paditësit, Gjykata ka vlerësuar se meqenëse kërkesa për shpërblim jubilar nuk gjen mbështetje në asnjë bazë juridike rrjedhimisht edhe kërkesëpadia për diskriminim është e pathemeltë kjo pasi që nuk mund të vërtetohet ekzistimi i diskriminimit duke marrë si referencë një kërkesë e cila nuk gëzon mbështetje ligjore. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata konform nenit 450 të LPK-së,

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk ka konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pa themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar të gjitha faktet, prandaj gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës si dhe përvoja e punës së paditësit tek e paditura nuk kanë qenë kontestuese.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 3 përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”. Paragrafi 4 përcakton se “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*”, ndërsa paragrafi 5 thekson se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës*

dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Po ashtu me nenin 52 paragrafi 1, pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015 dhe është aplikuar deri me datën 31.12.2017 përcaktohet se *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Sipas paragrafit 2 përcaktohet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”,* ndërsa paragrafi 3 parasheh se *“Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë e cila ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për arsyes se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka qenë në fuqi prej datës 01.01.2015 deri me datë 31.12.2017, ndërsa sipas shkresave në lëndës, konkretisht sipas vërtetimit të lëshuar nga e paditura për përvojën e punës së paditësit, konstatohet se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën me datë 01.12.2008 e që 10 vite të përvojës së punës (vitin jubilar) i ka arrit në vitin 2018 kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi, andaj në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa themeltë, për shkak të mungesës së bazës ligjore për realizimin e një kërkesë të tillë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale edhe për sa i përket pjesës së kërkesëpadisë në raport me diskriminim për faktin se kërkesa për shpërblim jubilar është e parashkruar si pasojë kërkesëpadia për diskriminim është e pathemeltë sepse baza e kërkesëpadisë për diskriminim ndaj paditësit ndërlihet me kërkesëpadinë për shpërblim jubilar. Kjo pasi që paditësi si shkak për ekzistimin e diskriminimit ndaj tij e pretendon mos-pagesën e shpërblimit jubilar nga e paditura, e cila kërkesë rezulton të jetë e parashkruar.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, andaj vendosi që aktgjykimin ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3337/2022, datë 12.03.2024

Numri i lëndës: 2021:193053
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05438324

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi